


+



Dona 03-09-2018

P.nr.2606/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni penal si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren , Hysnije Gashi si dhe me zyrtarë ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër te akuzuarit, [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj për shkak te veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2013-2/17 të dt. 18 tetor 2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.06.12.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/II.nr.2013-2/17 të dt. 18 tetor 2017 ,dhe kjo gjykatë shqipton këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED], i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me date 10.09.2017, rreth orës 12:30, në pyllin publik, ne vendin e quajtur “Zharina” ne Rajonin Ekonomiko Pyjor, Neredime-Jezerc, është takuar duke prere 10 cope trugje te ahut te njome, me diametër 30 centimetra, e me vëllim te përgjithshëm prej 4.70 metra kub e ne vlere prej 719.10, drunjtë kane qene te prere me sharre motorike dhe te transportuara me qerre kuajsh,-

Me te cilën kreu veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPK-së.

Andaj , Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

G J Y K O N

Të pandehurit, me dënim me gjobë në shumë prej 200€, (dyqind euro) të cilin dënim janë të obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, të njëjtëve do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

E dëmtuara Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj , për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2013-2/17 të dt. 18 tetor 2017 , ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprë penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.2013-2/17 të dt. 18 tetor 2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si: fletëparaqitja e rojës se pyllit me numër 646/2017, e dt.21.09.2017, i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, si dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil .

Obligohen të pandehurit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DIVIZIONI PENAL P.nr.2606/17 dt.06.12.2017

Zyrtare ligjore,
Albana Ujupi

Gjyqtarja,

Hysnije Gashi



UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.